



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Nr. 973 Prot.

Tiranë, më 14.07.2020

VENDIM
Nr. 49 datë 14.07.2020

MBI

MIRATIMIN E DATAVE TE KONKURSIT TË PRANIMEVE NË CIKLIN E PARË TË
STUDIMEVE PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021

Mbështetur në Urdhërin e Përbashkët nr. 02, datë 02.07.2020 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimit me karakter profesional, në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, si dhe në programet e ciklit të dytë të studimeve, në Institucionet e Arsimit të Lartë për vitin akademik 2020-2021” Rektorati në mbledhjen e datës 14.07.2020

V E N D O S I:

1. Dega e Informacionit Studentor dhe Rregjistrimeve brenda **06 Gushtit 2020** shkarkon nga Portali U-Albania listën e aplikantëve që konkurojnë në programet përkatëse të studimit dhe ia përcjell fakulteteve.
2. Fakultetet më datë **06 Gusht 2020** afishojnë në mjediset e tyre dhe në faqen zyrtare elektronike listën e aplikantëve për konkurim.
3. Datat e regjistrimit të aplikantëve për konkursin e pranimeve për vitin akademik 2020-2021 të jetë nga ora 9⁰⁰-15⁰⁰ pranë Degës së Informacionit Studentor dhe Rregjistrimeve të ndarë sipas qarqeve:
11-12 gusht 2020 – Qarku Kukës, Shkodër, Lezhë, Dibër, Gjirokastrë
13 Gusht 2020 - Qarku Durrës, Elbasan, Vlorë, Korçë, Berat, Fier
14,17,18 Gusht 2020 – Qarku Tiranë.
(aplikantët para se të bëjnë pagesën të verifikojnë emrin në listat e afishuara në UST)
4. **19 gusht** shpallja e listave të aplikantëve të regjistruar për konkurim në UST.
5. Datat e konkursit praktik në FVFR të jenë **21-22-23 gusht 2020**
6. Datat e konkursit praktik në FSHL të jenë **24-25-26-27 gusht 2020**.
7. Dokumentat që duhet të ketë kandidati për regjistrim për konkurs do të jenë:
 - 2 fotografi dokumenti 4x6
 - Fotokopje kartës së identitetit

- Mandat pagesa e tarifës së konkurimit
 - Kartela mjekësore
8. Të dhënat për Rregulloren e konkursit, testeve praktike, kartelës mjekësore dhe fatura e tarifës konkurimit gjenden në faqen zyrtare të UST.
 9. Brenda datës **28 Gusht 2020**, Dega e Informacionit Studentor dhe Rregjistrimeve afishon dhe publikon listën e renditjes së aplikantëve duke përdorur si element identifikues vetëm ID e tyre të maturës.
 10. **30 Gusht 2020** ngarkohet një kopje elektronike e këtyre listave në portalin U-Albania.
 11. Konkursi do të zhvillohet duke u bazuar në Rregulloren “Mbi masat sanitare për minimizimin e riskut nga COVID-19”. Çdo kandidat duhet të paraqitet në konkurs me doreza dhe maskë duke respektuar distancimin fizik
 12. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Dekanatet, Administratorja dhe Dega e Informacionit Studentor dhe Rregjistrimit, Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve, Drejtoria Shërbimeve Mbështetëse.
 13. Ky vendim shpallet në faqen zyrtare të UST-së.
 14. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR



Prof. Dr. Agron ÇUKA

